



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-048

Prishtinë, më 30 janar 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË TË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 30 JANAR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Duda Balje.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE: Sanije Berisha.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës. Ai propozoi që pika 3.1 të hiqet nga rendi i ditës dhe këtë e miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 janar 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Përgatitjet për shënimin e 17 shkurtit- Ditës së Pavarësisë të Republikës së Kosovës,
4. Kërkesa e grupeve parlamentare për seancë të jashtëzakonshme për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 janar 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 janar 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit, të mbahet të enjten, më 2 shkurt 2012, me këtë

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informatike,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për turizmin dhe shërbimet turistike,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmë juridike falas.

3. Kërkesa e grupeve parlamentare për seancë të jashtëzakonshme

Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci propozoi që, në bazë të deklaratës që e kanë nënshkruar liderët e partive politike, me përkrahjen e grupeve parlamentare, Kuvendi të mbajë seancë të jashtëzakonshme për të miratuar një rezolutë për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur.

Lidhur me këtë propozim diskutuan: Sabri Hamiti, Ardian Gjini dhe Visar Ymeri, të cilat janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, Kryesia konkludoi se kërkesa për të thirrur seancë të jashtëzakonshme, duhet të procedohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

4. Shënimi i 17 Shkurtit - Ditës së Pavarësisë së Kosovës

Kryetari i njoftoi të pranishmit me propozimin për të shënuar 17 Shkurtin - Ditën e Pavarësisë së Kosovës.

Lidhur me këtë pikë diskutuan: Ardian Gjini, Glauk Konjufca, Sabri Hamiti dhe sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, të cilat janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Autorizohen nënkryetarët e Kuvendit, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, që në bashkëpunim me Administratën e Kuvendit, Kryesisë së Kuvendit, në mbledhjen e ardhshme, t'ia paraqesin një propozim për shënimin e 17 Shkurtit- Ditës së Pavarësisë së Kosovës.
2. Në shënimin e 17 Shkurtit - Ditës së Pavarësisë së Kosovës, të ftohen, Grupi i Miqësisë i Parlamentit të Turqisë dhe përfaqësuesit e Kuvendit të Shqipërisë.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:40** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale